



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-7653 /2023
Kaçanik , 29.03.2023

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e Projekt -Propozimeve të OJQ-ve

Komuna e Kaçanikut, sipas Thirrjes Publike Nr. 01-104/02-7536 të datës 28.03.2023, për aplikim për subvencione në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2023, planifikon të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave joqeveritare në fushat prioritare që ndërlidhen me:

- a) Mbeshtetja, nxitja, fuqizimi, zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve të përgjithshme në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit
- b) Organizimi i ngjarjeve me karakter bashkëpunimi për promovimin e vlerave në fushat e kulturës rinisë dhe sportit
- c) Përfshirja e të rinjve në aktivitetet kulturor, rinore e sportive;

Përkatësisht :

↓ NË FUSHËN E KULTURËS

- Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore
- Promovimi i krijimtarisë lokale artistike
- Promovimi i trashëgimisë kulturore
- Festivalet, koncertet, shënimet e datave historike kulturore, simpoziumet dhe ekspozitat
- Përkrahja për grupet/shopqëritë kulturo-artistike që funksionojnë në komunë e Kaçanikut, do të mbështeten bazuar në realizimin e suksesshëm të programeve të tyre kulturore dhe artistike në vitet paraprake dhe planprogrami i tyre i punës për vitin 2023

✦ NË FUSHËN E RINIS E SPORTIT

- *Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjë që ndikojnë drejtpërdrejtë në nxitjen e aktiviteteve në fushat e ndryshme të përfshirë në strategjinë kosovare për rini dhe plan të veprimit;*
- *Promovimi i vulnetarizimit ;*
- *Avancimi i aktiviteteve në klubet sportive ;*
- *Masovizimi i sportit për të rinjë*
- *Përkrahja e klubeve publike sportive;*
- *Përkrahja e sportistëve kulmore dhe klubeve të suksesshme;*
- *Aktivitete edukative me simpatizantë me qëllim të evitimit të dhunës në sport*
- *Përkrahja për klubet që funksionojnë në komunën e Kaçanikut do të mbështeten bazuar në realizimin e suksesshëm të aktiviteteve/ programeve të tyre rinore e sportive në vitet paraprake dhe planprogrami i tyre i punës për vitin 2023.*

✦ Aktivitetet sipas planit të punës për vitin 2023/Drejtorina e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- *Organizimi i aktiviteteve sipas planprogramit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit*
- *Shënimi i datave të rëndësishme vendore, kombëtare e ndërkombëtare.*

Rregullorja MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësues për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve. Për këtë qëllim, Komuna e Kaçanikut, fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së institucionit do të caktohen në cilësinë e anëtarëve në komisione vlerësuese për të vlerësuar projekt -propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë të paktën 2 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 2 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet nga data 29.03.2023 deri më datë 24.04.2023 duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)

Komuna e Kaçanikut, do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm të cilët do të ftohen sipas nevojës për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese sipas thirrjeve publike që do të bëjë Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2023.

